

LIBRI I ABSTRAKTEVE

INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE on 'BALKAN SPORTS-DEVELOPMENTS & PERSPECTIVES'

DEPARTMENT OF SOCIAL & EDUCATIONAL SCIENCES
PHYSICAL EDUCATION AND SPORTS PROGRAM
TIRANA-ALBANIA



SH.LUJ "UNIVERSITETI
MARIN BARLETI"

May 20th 2017



UNIVERSITETI I SPORTEVE
Ë TIRANËS



University
of Ioannina



UNIVERSITÀ DI PISA



www.umb.edu.al

HOTEL "ADRIATIKU"

DURRËS-ALBANIA

Në kuadrin e bashkëpunimit rajonal dhe programeve ndërkufitare, Universiteti “Marin Barleti” (UMB) organizon një konferencë njëditore me temën **“Sporti Ballkanik-Zhvillime & Perspektiva” më 20 Maj, 2017, në Hotel “Adriatik”, Durrës-Shqipëri.** Kjo Konferencë rajonale do të promovojë bashkësinë e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe do të ndihmojë në përshpejtimin e Integritit European.

Universiteti “Marin Barleti” në bashkëpunim me institucione të edukimit fizik dhe sporteve si: **Universiteti i Sporteve Tiranë; Universiteti "Aleksandër Xhuvani"- Elbasan; Universiteti i Pizzas-Itali; Universiteti i Janinës-Greqi; Universiteti Shtetëror Podgoricë-Mal i Zi; Universiteti Shtetëror i Tetovës në Maqedoni; Universiteti Shtetëror i Prishtinës-Kosovë, Universiteti Shtetëror i Veliko Turnovo-Bullgari,** por dhe në bashkëpunim me **Komitetin Olimpik Shqiptar** dhe me **Federatën e Futbollit të Shqipërisë,** do të prezantojnë në Konferencë historinë e zhvillimit dhe perspektivat e të sporteve të vendeve të tyre përkatëse.

Si një pjesë përbërëse e përpjekjeve të Shqipërisë për të ndërtuar marrëdhënie më të mira midis vendeve ballkanike, ky aktivitet do të shërbejë gjithashtu si diplomacia më e mirë, për të kapërcyer dallimet gjuhësore dhe social- kulturore dhe do të forcojë kohezionin midis këtyre .

Dijetarë dhe kërkues shkencorë në lëmin e edukimit fizik dhe sporteve, mësues, ekspertë, gazetarë, personalitete të sportit, si edhe studentë janë të mirëpritur të marrin pjesë në këtë Konferencë. Konferenca do të shërbejë gjithashtu si një stimul për gjeneratën e re të këtyre vendeve për t'u frymëzuar nga arritjet sportive të paraardhësve të tyre.

Në konferencë mund të paraqiten artikuj shkencorë dhe postera.

GJUHA E KONFERENCËS: Shqip dhe anglisht

MATERIALET E KONFERENCËS: Punimet e konferencës do të botohen në revistën shkencore “Gjeopolitika” të UMB, pas aprovimit nga komiteti shkencor i konferencës. Ndërkohë në faqen zyrtare të internetit të UMB www.umb.edu.al është publikuar programi i konferencës, libri abstrakteve, organizatorët, sesionet e konferencës, indeksi i pjesëmarrësve etj., në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 467, datë 18. 07. 2007 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për kualifikimin shkencor e pedagogjik të personelit akademik”. Në fund të prezantimit pjesëmarrësit dhe prezantuesit do të pajisen me certifikatë.

KOMITETI SHKENCOR:

1. Prof.Dr.Marenglen Spiro, Universiteti “Marin Barleti” Tiranë-Shqipëri. (UMB)
2. Prof.As.Dr.Zamira Çavo Universiteti “Marin Barleti” Tiranë-Shqipëri. (UMB)
3. Prof.Dr.Lluka Heqimi, Universiteti “Marin Barleti” Tiranë-Shqipëri (UMB)
4. Prof.Dr.Rauf Dimraj, Ministria e Arsimit dhe Sportit Tiranë-Shqipëri (MAS)
5. Prof. Dr Vullnet Ameti, Universiteti Shtetëror i Tetovës-Maqedoni
6. Prof.Dr.Gëzim Hadaj, Universiteti “Marin Barleti” Tiranë-Shqipëri (UMB)
7. Prof.Dr. Rashit Hadzic, Universiteti Shtetëror i Podgoricës-Mal i Zi
8. Prof.Dr.Bardhyl Misja, Universiteti i Sporteve Tiranë-Shqipëri (UST)
9. Prof.Dr.Albert Karriqi, Universiteti i Sporteve Tiranë-Shqipëri (UST)
10. Prof.Dr. Lumturi Markolaj, Universiteti i Sporteve Tiranë-Shqipëri (UST)
11. Prof.Dr.Xhovani Armilota, Universiteti i Pizzas-Itali
12. Prof. Dr.Andrea Gudha, Universiteti “Marin Barleti” Tiranë-Shqipëri (UMB)
13. Prof.Dr.Florian Vila, Universiteti i Tiranës-Shqipëri
14. Prof.Dr.Lydmil Petrov, Universiteti i Veliko Turnovo-Bullgari
15. Prof.As.Dr.Gavrosh Kavaja, Universiteti “Marin Barleti” Tiranë (UMB)
16. Prof.As.Dr.Azir Saliu, Universiteti Shtetëror i Prishtinës-Kosovë
17. Prof.As.Dr.Bujar Kasmi, Universiteti i Sporteve Tiranë-Shqipëri (UST)
18. Prof.As.Dr.Ardian Shingjergji, Universiteti “A.Xhuvani” Elbasan-Shqipëri (UE)
19. Prof.As.Dr. Spiro Kuvarati, Universiteti i Sporteve Tiranë-Shqipëri (UST)
20. Dr.Metsios T.Georgois, Universiteti i Janinës-Greqi
21. Dr.Robert Gjedia, Universiteti “Marin Barleti” Tiranë-Shqipëri. (UMB)

KOMITETI ORGANIZATOR:

1. Prof.Dr.Lluka Heqimi
2. Prof.Dr.Gëzim Hadaj
3. Dr.Robert Gjedia
4. Prof.As.Dr.Gavrosh Kavaja
5. Msc.Sokol Jareci
6. Msc.Silvana Delia
7. Msc.Ilia Kuro
8. Msc.Enkelda Braho

Vangjel Zhapa-Nderi i Kombit Shqiptar, themelues i Lojrave Olimpikë moderne

Prof.Dr. Bardhyl Misja¹

Pedagog i edukimit fizik dhe sporteve në UST

Prof.Dr. Lluka Heqimi²

Pedagog i edukimit fizik dhe sporteve në UMB

Dr.Dhimitraq Dhjako³

Mësues i edukimit fizik, Toronto-Kanada

Abstrakt

Në këtë artikull autorët trajtojnë figurën e një personaliteti të madh shqiptar, deri më sot deri diku i harruar. Ata kanë hulumtuar në jetën e tij nëpërmjet dokumenteve arkivore, evropiane, ngjarjeve sportive, intervistave me njëerz që kanë zhvilluar kërkime për të brenda dhe jashtë vendit. Ata kanë identifikuar një aktivitet të plotë dhe të vullshëm të jetës së tij. Vangjel Zhapa u bë një nga njerëzit më të pasur të Europës dhe, për çudinë e të gjithëve, ai e shpërndau këtë pasuri për të mirën e përgjithshme, jo vetëm ballkanike, por edhe evropiane. Vizionet e tij ishin të gjera, me botime librash dhe ndërtimesh të vlefshme në fushën e artit, kulturës, arsimimit, kultit fetar, pa diferenca për të gjithë popujt ballkanik.

Autorët paraqesin aktivitetin e Vangjel Zhapës në rilindjen e Lojrave Olimpikë që jo vetëm i ideoi, por dha donacione për të gjitha shpenzimet, duke futur këtu edhe shpërblimet e fituesit. Sot ai konsiderohet donatori i përhershëm i Lojrave Olimpikë. Në material gjenden letrat e komunikimit midis mbretit Otto të Greqisë dhe Vangjel Zhapës. Me këmbëngulje ai i bindi të gjithë dhe realizoi katër olimpiada, ku e fundit pati një karakter gati ndërkombëtar. Në të vërtetë ai arriti të shohë vetëm njëerë nga ato, të parën. Janë të shumta dokumentet dhe prapaskenat e shkruara në to që vërtetojnë përpjekjet e qëllimshme për ta rrëzuar atë si ideatorin e Lojrave Olimpikë. Autorët sjellin letërkëmbimet midis presidentit të parë të Lojrave Olimpikë Aleksandër Vikelas me Kubertenin. Po ashtu autorët kanë shfrytëzuar materiale të larmishme nga historianë të shquar të Olimpizmit si David Joung, i cili ka thënë se Lojrat olimpikë kanë yllin e kometës- Vangjel Zhapa dhe pas tij vjen anglezi Brooks dhe francezi Pjer De Kuberten. Vendosija e këtij të fundit, thotë ai, në krye të olimpizmit botëror është një padrejtësi e historisë. Kështu, Lojrat Olimpikë janë 37 vite më të vjetra se sa përshkruhen. Vetëm një përpjekje e përgjithshme kuptimdrejtë do të jetë zgjidhja për të mos turpëruar vetë historinë e Lojrave Olimpikë. Autorët sugjerojnë që kontributi i Zhapës të jetë objekt kërkimi dhe studimi për studentët e universiteteve të sporteve, sepse kjo figurë ka një rol dhe peshë specifike në mbarë lëvizjen olimpikë botërore, gjë për të cilën shqiptarët duhet të ndjehen krenarë.

Fjale kyçe: Vangjel Zhapa, Olimpiket e Zhapës, Lojrat Olimpikë, letërkëmbim, kërkim

¹ bmisja@ust.edu.al

² llukaheqim@gmail.com

³ ddhjaku@hotmail.com

Ymer Pampuri rekordmeni botëror dhe olimpik i Shqipërisë

Prof.Giovanni Armillota⁴
Pedagog i shkencave sportive
Universiteti i Pizzas-Itali

Abstrakt

Prezantimi “Ymer Pampuri rekordmeni botëror dhe olimpik i Shqipërisë” sjell për të interesuarit e sportit të peshëngritjes shqiptare gjetje dhe analiza që lidhen me rekordmenin shqiptar të peshëngritjes. Autori me anë të shqyrtimit të literaturës on-line, të botimeve të vijueshme në Shqipëri si: ‘Futbolli shqiptar’ , “Sporti Shqiptar” ka arritur të identifikojë, të studiojë dhe të paraqesë konkluzione dhe rekomandime lidhur me ecurinë, stërvitjen dhe suksesin e këtij personaliteti sportiv me famë botërore të Shqipërisë. Do të ishte viti 1972 në Lojërat Olimpike Botërore ku do të shpërthente talenti i spikatur i Ymer Pampurit, për ta bërë atë një individ që me stilin e tij të veçantë të peshëngritjes të mbetej njëkohësisht kampion dhe rekordmen botëror i peshëngritjes. Ai i takonte peshën 60 kg, por arriti të sfidojë me stilin e tij veten dhe gjithë peshëngritjen botërore, duke ngritur 125 kg-127,50 kg. Ky është një rekord që sportisti shqiptar, që nuk jeton më, e arriti në atë vit, duke e lartësuar peshëngritjen shqiptare në nivelet me të larta botërore. Paraqitja e suksesit të Ymer Pampurit në këtë konferencë është një shtysë që sportistët e peshëngritjes të motivohen më shumë për të patur suksese në kompeticonet evropiane dhe botërore.

Fjalë kyçe: Peshëngritje, stërvitje, rekordmen, kampion, motivim.

⁴ ga57@yahoo.com

Futboll 2016. Shqipëria në finalet e Kampionatit European për të rritur

Msc.Irfan Rama⁵

Gazetar Sportiv

Msc.Sokol Jareci⁶

Kryetar i Komisionit të
Arbitrimit pranë FSHF

Abstrakt

Në një sfidë të vazhdueshme për të rritur cilësinë dhe rezultatin e ekipit përfaqësues, Shqipëria kishte ëndërruar një arritje të madhe historike për tu kualifikuar në finalet e një Botërori apo Europeani për dekada. Eleminoret e Kampionatit European “Francë 2016” pasqyruan rritjen progresive të përfaqësueses shqiptare duke rimarrë gjurmë të ndeshjeve cilësore nga Eleminoret e Botërorit “Brazil 2014”. Në këtë studim autorët synojnë të paraqesin gjetjet e tyre kërkimore në të analizuarit e suksesit të futbollit shqiptar nëpërmjet përfaqësueses shqiptare si fenomen sportiv në kushte specifike të një futbollit në zhvillim, por dhe të ofrojnë rezultatet dhe rekomandimet e tyre në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të këtij sporti yjor në Republikën e Shqipërisë. Metodologjia kërkimore e përdorur në këtë analizë përfshin hulumtimin historik, taktik, menaxhues për 2 dekadat e fundit me fokus të dedikuar në fazën e kualifikatorëve të Europeanit 2016, ku Shqipëria bëri historinë e futbollit shqiptar. Elemente metodologjike të kësaj pune kërkimore janë analiza, sinteza, krahasimet, statistika të ndeshjeve të përfaqësueses, intervista dhe vrojtime në thellësi të elementëve përcaktues të arritjeve dhe rezultateve sportive. Suksesi i arritur i ekipit kombëtar të futbollit në “EURO 2016” nën drejtimin e trajnerit Gianni De Biasi rezulton të jetë produkt i një revolucioni të gjithanshëm në përzgjedhjen e lojtarëve, krijimin e 3-4 skuadrave në çdo post, rregullave dhe konceptimeve taktike, ekologjisë sportive e ngjizjes së mentalitetit fitues, risi të skemave efektive, individualitetit dhe kolektivitetit të individëve etj.

Fjalë kyçe: Revolucion, taktikë, mentalitet, rezultat, feedback.

⁵ irfanrama@hotmail.com

⁶ sjareci@fshf.org.al

Sporti Bullgar dhe sukseset në ndeshjet ndërkombëtare në basketboll, volejball dhe futboll.

Prof. Dr. Lyudmil Petrov⁷

Fakulteti i Edukimit, Universiteti “Veliko Turnovo” Bullgari

Prof. As. Dr. Svetoslav Stefanov⁸

Fakulteti i Edukimit, Universiteti “Veliko Turnovo” Bullgari

Dr. Edmond Biçoku⁹

Fakulteti i Edukimit, Universiteti “A. Xhuvani” Elbasan

Abstrakt

Artikulli shqyrton sukseset e ekipeve të lojrave sportive në Bullgari- basketboll, volejball dhe futboll. Metoda e hulumtimit arkivor është baza e këtij informacion kërkimor. Ekipeve sportive të Bullgarisë në basketboll, volejball dhe futboll kanë suksese të rëndësishme në garat ndërkombëtare. Sukseset më të vlerësuara në Olimpiadë dhe kampionate botërore janë: Ekipi i basketbollit që ka fituar medalje argjendi në Olimpiadën në vitin 1980 dhe një bronz në vitin 1976, ndërsa në Kupën e Botës ka fituar një medalje argjendi në 1959. Kombëtarja e futbollit të meshkujve të Bullgariasë fitoi medalje argjendi në Olimpiadën në Meksikë në vitin 1968 dhe një medalje bronz në Olimpiadën në Melburn, në Australi në vitin 1952, në Kampionatin botëror - medalje bronz në ekip 1994. Kombëtarja e volejbollit të meshkujve të Bullgarisë është në elitën botërore dhe ka një medalje argjendi në nivel Olimpiada e Moskës në vitin 1980, një medalje argjendi dhe dy bronz në kampionatin Botëror dhe argjendi e 4 bronz në kampionatet evropiane.

Fjalë kyçe: Basketboll, volejball, futboll, arritje, suksesi ndërkombëtar

⁷ Ludmilpetrov55@gmail.com

⁸ stambolov27@abv.bg

⁹ edmonbicoku@yahoo.com

Disa faktorë vendimtarë të suksesit në sporte

Msc.Metsios T. Georgios¹⁰

Pedagog i Edukimit Fizik dhe Sportit

Universiteti i Janinës dhe Përgjegjësi i Qendrës Sportive Metsovosë Janinë

Greqi

Abstrakt

Autori në këtë artikull paraqet arritjet e dy ekipeve të njohura greke, si: Ekipi kombëtar i basketbollit grek në Euro 1987, ekipin kombëtar të futbollit grek në Euro 2004 në Portugal. Nëpërmjet vëzhgimit të ndeshjeve, analizës së përgatitjes fizike dhe teknike të lojtarëve, si dhe me anë të shqyrtimit e rezultateve, identifikohen pikat e forta të ekipeve që mundësuan arritje në këto gara.

Kampionati evropian 03-14 qershor 1987 Greqi.

Ky është një nga eventet më vështira europiane për të gjitha kohërat. Në të morën pjesë ekipet më të fuqishme të kampionatit Evropian, si ish-Bashkimi Sovjetik, ish-Jugosllavia, Spanja, etj. Në 1987, askush nuk priste që në mes atyre ekipeve të triumfonin grekët. U fitua me ish-jugosllavët, me ish-sovjetikët që ishin ekipe me shumë lojtarë të fortë të njohur në mbarë botën. Kjo fitore ishte një mrekulli që i dha një motivim grekëve për të qenë fituesit në këtë kampionat.

Kampionati evropian 2004, 12 qershor - 4 korrik Portugal.

Ekipi grek shfaqti një pjesëmarrje të mahnitshme, duke u përballur me më të mirët si: Franca, Portugalia, Çekia, me guxim dhe vendosmëri absolute. Ne humbëm vetëm një lojë me Rusinë 2-1 dhe fitoi, me vendlindjen e Ronaldos, dy herë në fillim të turneut 2-1 dhe 1-0 në finale, si dhe Francën dhe Çekinë.

Suksesi i ish dy ekipeve kombëtare është rezultat i faktorëve të paraqitura më poshtë, si: Përkushtim të fortë të trajnimit; dashuri dhe pasion për sportin; respekt dhe bindje ndaj trajnerit të tyre; mbështetja nga familjet dhe tifozët e tyre. Megjithatë, faktori më i rëndësishëm për suksesin, besoj se është marrëdhënia në mes të lojtarëve dhe elemente psikologjike, të tilla si: Miqësia e fortë në mesin e lojtarëve; mbështetje dhe njohjen e aftësive të çdo lojtari por veçanarisht ata punuan si një ekip të vërtetë për të arritur majën.

Fjalët kyçe: Përkushtim i fortë, njohje, respekt, dashuri, miqësia.

¹⁰ gmetsios@yahoo.gr

Arritjet e peshëngritjes shqiptare ndër vite

Akademik, **Prof. Dr.Gudar Beqiraj**¹¹

Msc. Elez Gjoza¹²

President i Federatës Shqiptare të Peshëngritjes

Msc.Erkand Qerimaj¹³

Kampion i Europës

Abstrakt

Objekti i studimit “Arritjet e peshëngritjes shqiptare ndër vite” është sporti i peshëngritjes, i cili ka arritur rezultatet më të larta në arenën ndërkombëtare. Është sporti që i ka dhënë Shqipërisë medaljen e vetme të artë, botërore. Evidentimi i rezultateve më të mira ndër vite ishte synimi i këtij studimi. Metodologjia mbi të cilën autorët kanë hulumtuar është grumbullimi i të dhënave dhe përpunimi sasior i tyre me qëllim evidentimin e hapit cilësor në këtë lloj sporti si në drejtim të cilësisë sportive po ashtu edhe në rritjen e numrit të pjesëmarrësve. Nga analiza e të dhënave rezultoi se pas çdo arritje në nivel ndërkombëtar, kishte një rritje të pjesëmarrjes së të rinjve dhe një rritje të madhe e konkurrencës midis peshëngritësve të ekipeve të ndryshme, prej nga dolën peshëngritës të niveleve botërore. Pikërisht në këto vite nisën të garojnë shumë peshëngritës të talentuar që shkëlqyen në kompeticionet evropiane dhe botërore. Shqipëria kurdoherë ka patur edhe peshëngritëset-femra, të pakta në numër, por shumë cilësore. Medaliste Europe si Fetije Kasaj e Romela Begaj, si dhe vendi i 8-të në Olimpiadë, Evangjeli Veli. Rezultatet e këtij studimi synojnë të ndërgjegjësojnë strukturat shtetërore të sportit, por jo vetëm, për hartimin e strategjive sportive në shërbim të ketyre sporteve që sigurojnë një impakt social në arenën ndërkombëtare, si një kontribut për integrimin në Bashkimin European.

Fjalë kyçe: Peshëngritje, kërkim, medalje, analiza, reflektive

¹¹ gbeqiraj@yahoo.com

¹² egjozaj@yahoo.com

¹³ eqerimaj@yahoo.com

Mundja dhe sot në Republikën e Maqedonisë

Prof.Dr.Vullnet Ameti¹⁴

Universiteti i Tetovës-Maqedoni, Fakulteti i Kulturës Fizike

Prof.As.Dr.Blerim Saiti¹⁵

Universiteti i Tetovës-Maqedoni, Fakulteti i Kulturës Fizike

Prof.As.Dr.Shpresa Memishi¹⁶

Universiteti i Tetovës-Maqedoni, Fakulteti i Kulturës Fizike

Abstrakt

Mundja është një ndër sportet me të vjetra të njerëzimit, por dhe një ndër sportet tradicionale dhe me shumë rezultate të arritura në të kaluarën e Maqedonisë. Sporti i mundjes në Maqedoni ka nxjerrë mundës që kanë shkruar histori në Olimpiadë siç është Shaban Tërstena, Shaban Sejdiu etj. Qëllimi i punimit tonë është që të bëjmë një analizë të sportit të mundjes nga e kaluara deri në ditët e sotme, cilat ishin të arriturat në të kaluarën dhe të sotmen dhe cilët janë faktorët e ngecjes për arritjen e rezultateve në të sotmen. Me anë të vëzhgimit nga afër të gjendjes së mundjes në Maqedoni dhe shfrytëzimit të literaturës në lidhje me problematikën në fjalë, arrijmë në këto konkluzione se Federata e Mundjes në Maqedoni duhet urgjentisht, përmes projekteve të ndryshme, të fillojë ngritjen e nivelit të mundjes tek gjeneratat e reja, sporti i mundjes të fillojë të futet në programet e edukimit fizik në shkollë, sistem i organizimit të garave në nivel ballkanik si p.sh. Liga Ballkanike në të cilën do marrin pjesë shtetet e rajonit për të vetmin qëllim ngritjen e cilësisë së sportit të mundjes.

Fjalë kyçe: Maqedoni, sport, mundje, olimpizëm, rezultate

¹⁴ vullnet.ameti@unite.edu.mk

¹⁵ blerim.saiti@unite.edu.mk

¹⁶ shpresa.memishi@unite.edu.mk

Themeluesit dhe organizatorët e sportit shqiptar

Msc.Xhorxhi Vasili¹⁷, Historian sporti
Dr.Mustafa Fagu¹⁸,
Pedagog i shkencave sportive UMB
Msc.Ahmet Shqarri¹⁹, Gazetar sportiv
Msc.Fatmir Mneri²⁰, Gazetar sportiv

Abstrakt

Fillimet e lëvizjes sportive në Shqipëri i gjejmë në dhjetëvjeçarin e dytë të shekullit të kaluar. Më 1913 e më pas do të zhvillohen disa ndeshje futbollit me austriakët, italianët, francezët si dhe gara atletike e çiklistike. Duke nisur nga 1919 nis krijimi i shoqërive kulturore e sportive: “Vllaznia” Shkodër (1919), “Namik Delvina” Delvinë (1919), “Teuta” Durrës, “Shqiponja” Gjirokastër, “Skënderbeu” Korçë, “Butrinto” Sarandë, “Besa” Kavajë, “Ismail Qemali” Vlorë, “Dragoj” Pogradec etj. Rinia filloj të merrej edhe me not, tenis, basketboll, skautizëm. Në këto vite kemi themelimet e mëdha të sportit shqiptar si i pari rreth çiklistik për amatorë në Evropë (1925), kampionati i atletikës (1929, ai i futbollit (1930), i notit (1931). Rëndësi patën pjesëmarrjet në veprimtari ndërkombëtare si Olimpiadat Ballkanike të atletikës në Athinë (1933), Zagreb (1934), Stamboll (1935), Beograd (1938) si dhe formimi i kombëtares së futbollit (1936). Qeveria u përpoq ta mbështeste zhvillimin e sportit, sidomos ministria e arsimit për edukimin fizik në shkolla duke e lidhur me rritjen e frymës patriotike. Licetë dhe gjimnazet u bënë strumbullari i veprimtarive sportive. Rol përcaktues luajtën organizma si Enti Kombëtar “Djelmënia Shqiptare”, Federata sportive Shqiptare, Komiteti Teknik Arbitral që hodhën themelet e një sporti modern kombëtar.

Shteti dërgoi jashtë vendit shumë të rinj për tu shkolluar në universitetet më në zë të Evropës. I rëndësishëm ishte aderimi në organizmat ndërkombëtare si IAAF, FIFA, FINA etj.

Në këtë periudhë shkëlqyen personalitet e jashtëzakonshëm si: Ministrat Hil Mosi e Mirash Ivanaj, pedagogët e specialistët Palok Nika, Vasfi Samimi, Selman Stërmasi, Luigj Shala, Anton Mazreku, Telemak Nushi, Bahri Toptani, Alush Lleshanaku, Ahmet Ashikja, Bexhet Jolldashi, Gaqo Gogo, Avni Zajmi, Irfan Tërshana etj., si dhe të huajtë Oakley-Hill, De Markis.

Këto vite kanë çuar në disa problematika që duhet të trajtohen me seriozitet dhe saktësi. Duhet të hartohet një historiografi sportive, të ketë studime dhe botime, albume, dokumentarë, bibliografi si dhe vlerësime reale të kontributit të atyre që vunë gurët në themelin e sportit shqiptar.

Fjalë kyçe: Shoqëri kulturore, veprimtari, sport kombëtar, personalitete.

¹⁷ xhoxhivasili@yahoo.com

¹⁸ mfagu@yahoo.com

¹⁹ ashqarri@yahoo.com

²⁰ fmneri@yahoo.com

Shqipëria organizatore dhe fituese e kampionatit Ballkanik në vitin 1946

Msc.Fatmir Efica²¹,

Përgjegjës i Klubit të Sporteve, Bashkia Kavajë

Dr. Bashkim Delia²²

Fakulteti Veprimtarive Fizike dhe Rekreacionit UST

Prof.As.Dr.Bujar Kasmi²³

Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes UST

Abstrakt

Prezantimi “Shqipëria organizatore dhe fituese e kampionatit ballkanik në vitin 1946” sjell për të interesuarit në fushën e zhvillimit të sporteve fakte dhe shembuj konkretë të proceseve të planifikimit, të menaxhimit dhe arritjen e fitores ballkanike në futboll. Autorët nëpërmjet shqyrtimit të materialeve të kohës, me anë të bisedave dhe intervistave me persona të asaj kohe, por dhe me anë të shqyrtimit të dokumenteve arkivore, sportive kanë arritur të analizojnë dhe të paraqesin për grupet e interesit: Kronologjinë e Ballkaniadës, futbollistët pjesëmarrës, zhvillimin e ndeshjeve, individët më të spikatur, duke i trajtuar dhe në kontekstin e vitit 1946, dy vite pas çlirimit dhe djales së Shqipërisë nga Lufta e Dytë Botërore. Është ky event që shënoi përpjekjet dhe institucionalizimin e parë të një bashkëpunimi të ndërsjelle dhe kulturor midis vendet ballkanike, duke ndikuar fuqishëm në zhvillimin e nje perspektive pozitive të sportit në Ballkan.Përmasat e këtij aktiviteti e bënë më të njohur ndërkombëtarisht Shqipërinë si vend organizator. Nga ana tjetër prezantimi paraqet përgatitjet, cilësitë dhe motivimin e shquar të lojtarëve dhe të drejtuesve të ekipit kombëtar që arriti fitoren e këtij kampionati, si një nga sukseset që mbetet gjallë në kujtesën tonë sportive, por dhe si një themel i fortë që ndikoi fort në një të ardhme pozitive të zhvillimit të futbollit në Shqipëri. Kjo fitore mbetet një përvojë e sukseshme për këtë sport në vendin tonë. Autorët nëpërmjet evokimit të këtij eventi u sugjerojnë ekipeve të futbollit dhe institucioneve përkatëse që vetëm me motivim, me përgatitje te vijueshme fizike dhe teknike arrihet fitore dhe cilësi sportive.

Fjalë kyçe: Kampionat ballkanik, ekip kombëtar, cilësi, motivim, fitore.

²¹ fatmiref@yahoo.com

²² bashkimdelia@yahoo.com

²³ bujarkasmi@yahoo.com

Shqipëria në Lojëat Mesdhetare, Latakia 1987

Dr. Stavri Bello²⁴

Sekretar i përgjithshëm KOKSH

Msc.Mehdi Bushati²⁵

Specialist dhe drejtues i sportit

Msc.Kliton Muça²⁶

Punonjës i KOKSH

Abstrakt

Me anë të këtij prezantimi jepet një panoramë e qartë e pjesëmarrjes së Shqipërisë e përfaqësuar nga Lëvizja Olimpike te ngjarjet sportive madhore të rajonit siç janë Lojërat Mesdhetare, si dhe hedh dritë mbi mënyrën administrative të marrjes së vendimeve politike sportive në kohë. Gjithashtu artikulli përfaqëson një analizë të përfaqësimit të sportistit shqiptar në pothuajse të gjitha pjesëmarrjet në këto Lojëra. Ky studim u realizua për të parë se si është zhvilluar konteksti historik dhe ai politik i pjesëmarrjes së Shqipërisë në Lojërat Mesdhetare, gjithashtu për të vlerësuar evoluimin e pjesëmarrjes dhe rezultatet në edicionet pjesëmarrëse. Në këtë material janë shqyrtuar dokumente të ndryshme, botime në gazetat e kohës, buletine të rezultateve, dokumente të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) dhe janë intervistuar individë të ndryshëm pjesëmarrës dhe protagonist. Sporti ka shërbyer gjithmonë si mjete më i mirë diplomatik në zgjidhjen e situatave politike dhe gjeopolitike rajonale dhe kontributi i Shqipërisë qoftë me pjesëmarrjen si edhe me rezultatet sportive ka treguar vlerat me luhatjet e vetë zhvillimeve social-ekonomike të paraqitura në dimensione kohore të ndryshme por gjithashtu edhe mënyra e administrimit dhe menaxhimit të sistemit sportiv në këto etapa kohore. Studimi është tërësor dhe jep një panoramë të përgjithshme rreth politikave sportive në vend dhe ato rajonale si dhe elemente të tjerë të ndryshimeve sociale, kulturore, ekonomike dhe gjithashtu teknologjike. Pengesë për një studim më të thellë është numri i pakët i studimeve shkencore për këtë çështje, por do të jetë një mundësi e mirë një kërkim më të gjerë në të ardhmen duke iu referuar edhe dokumentave të vendeve të pellgut të mesdheut.

Fjalë kyçe: Lojëra Mesdhetare, politika sportive, lëvizja olimpike, KOKSH, struktura sportive

²⁴ stavribello@yahoo.com

²⁵ mbushati@yahoo.com

²⁶ kmuco@yahoo.com

Majlinda Kelmendi një personalitet i sukseseshëm i sportit kosovar dhe botëror

Prof.As.Dr. Azir Saliu²⁷
Universiteti i Prishtinës-Kosovë

Abstrakt

Ky prezantim paraqet arritjet e rezultateve shumë të larta të xhudistes kosovare Majlinda Kelmendi, punën e realizuar me të, metodat e përdorura në stërvitje, intensitetin dhe volumin, stërvitjen me vullnet me tre seanca në ditë , që ofruan rezultatet e suksesit. Artikulli shtjellon analizat e studimit, suksesin e fitores, ballafaqimin me sportiste të tjera të nivelit të saj, rezultatet dhe perspektivën për të ardhmen, si dhe ruajtjen e suksesit të arritur, që është sfidë e vështire për një kampione botërore. Në shtetin më të ri të Ballkanit nuk ka se si të mos përmendet rezultati fenomenal i xhudistes Kosovare Majlinda Kelmendi (kampione Olimpikë dhe kampione e Botës në vitin 2016). Me gjithë vështirësitë e njohjes së sportit kosovar nga Federatat e ndryshme sportive të Europës dhe të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, përpjekjet e vazhdueshme për t'u përfaqësuar në fillim me ekipin e Shqipërisë, e më vonë me njohjen e Kosovës si shtet i pavarur, dëshira për rezultate të larta sportive nuk ka munguar, stërvitja me pasion të dyfishtë që ky shtet i ri të përfaqësohej, e arriti qëllimin.Me kurorën e ullirit në kokë dhe medaljen e artë të Kampionit Olimpik të varur në qafë, sytë e përplotur nga gëzimi, gjë që emocionoi me qindra mijëra shqiptarë kudo që ndodheshin, për krenarinë e të qenit shqiptar, kjo ishte arritja më e madhe. Kënaqësia më e madhe ishte momenti kur u këndua Hymni i Kosovës, si një nga shtetet më të rinj të botës, vendi më i ri e i pavarur i Ballkanit. Më pas rezultatet vazhdojnë si kampione e Europës dhe së fundmi Kampione Bote, një rast i rrallë për një individ apo skuadër me rezultate që të bënë krenar. Puna e zhvilluar. metodat e përdorura në stërvitjen e saj, kohëzgjatja dhe intensiteti janë realisht objekte analize dhe shembulli motivues për arritje dhe të sportistëve të tjerë.

Fjalë kyçe: Sporti kosovar, xhudo, stërvitje cilësore, kampione, krenari

²⁷ bhsg@live.com

Arritjet kombëtare dhe ndërkombëtare të volejbollit shqiptar me anë të ekipeve të Dinamos femra dhe meshkuj, përvoja të sukseshme sportive që na motivojnë.

Msc.Leonard Tase²⁸

Koordinator për aktivitetet ndërkombëtare në federatën e volejbollit në Kosovë

Msc.Vangjel Koja²⁹

Trainer kombëtar

Msc.Kreshnik Tartari³⁰

Trainer kombëtar

Doc.Hysen Domi³¹

Pedagog i shkencave sportive Universiteti “A. Xhuvani” Elbasan

Msc.Enkeleda Braho

Pedagoge e shkencave sportive UMB³²

Abstrakt

Prezantimi “Arritjet kombëtare dhe ndërkombëtare të volejbollit shqiptar me anë të ekipeve “Dinamo” femra-dhe meshkuj, përvoja të sukseshme sportive që na motivojnë” sjell për të interesuarit dhe dashamirësit e këtij sporti të dhëna, statistika, procese të seleksionimit të lojtarëve volejbollistë, procese të stërvitjes së femrave dhe meshkujve të ekipeve “Dinamo” për dekadën 1970-1980, e cila mbetet padyshim një kohë e paharruar për sukseset e larta të volejbollit shqiptar.

Autorët kanë shfrytëzuar literaturën sportive të kohës, dokumentet arkivore, kanë rikujtuar dhe analizuar përvojat e tyre të drejtpërdrejta në këto ekipe, duke mundësuar në këtë prezantim një analizë të gjerë të planifikimit, të stërvitjes, të përzgjedhjes së lojtarëve, të arritjeve të femrave dhe meshkujve volejbollistë të Dinamos.

Artikulli identifikon lojtarët më në zë të femra - meshkuj të këtij ekipi të njohur në të gjithë vendin, por dhe të dhëna interesante për ndeshjet e fituara brenda dhe jashtë vendit, që dëshmojnë cilësi, përgatitje dhe përkushtim sportiv.

Autorët gjykojnë se prezantimi i përvojës së “Dinamos” femra-meshkuj është një gjetje e mirë, sepse dhe sot vlejnë shumë elemente profesionale të këtij ekipi, të cilat duhen marrë në konsideratë nga ekipet aktuale të volejbollit.

Fjalë kyçe: Volejboll, ekipi “Dinamo”, femra-meshkuj, stërvitje, sukses.

²⁸ leo.tase@gmail.com

²⁹ vkoja@yahoo.com

³⁰ ktartari@yahoo.com

³¹ hdomi@hotmail.com

³² enkibraho@gmail.com

Studimi i obezitetit me nxënësit e moshës 6-18 vjeç në qytetin e Durrësit baza e një strategjie të re të edukimit fizik për Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve

Prof. Dr. Rauf Dimraj³³

Zëvendës/Ministër i Arsimit dhe Sportit

Abstrakt

Zhvillimi masiv i përshtatshëm, e i individualizuar i edukimit fiziko-sportiv, për gjithë fëmijët dhe nxënësit, përfshirë subjektet me aftësi të veçanta, ndikon në formimin e një mënyre të shëndetshme jetese, që garanton rritjen e rendimentit kardiak-respirator-vaskular, fizik, lëvizor, psikologjik, kognitiv, shëndetësor, social dhe ekonomik të shoqërisë sonë. Masivizimi i zhvillimit të mësimdhënies për edukimin fiziko-lëvizor të subjekteve të moshave 3-18 vjeç është zgjidhja më efikase, për të edukuar dhe formuar qytetarë të shëndetshëm, intelektualë, humanë, produktivë cilësorë në jetë, e që garantojnë rritjen e mirëqenies kombëtare. Mësuesit e gjithë fushave të tjera, tashmë njohin përgjegjësinë e mësuesve të edukimit fizik dhe rëndësinë e misionit të tyre. Vlerësimi i indeksit të masës trupore, BMI, për nxënësit e moshës 6-18 vjeç të qytetit të Durrësit, nëpërmjet matjes së peshës dhe lartësisë trupore, për të përcaktuar intervalin e "normalitetit" të peshës së tyre trupore, paraqitet si treguesi më i mirë i dhjavit trupor e i rrezikut nga sëmundjet dhe është i pari i këtij lloji në Shqipëri, për nga përmasat e testimit.

Fjalë kyçe: Edukim fizik, mësues, zhvillim, shëndet, fizik.

³³ Rauf.Dimraj@arsimi.gov.al

Sukseset Ballkanike dhe Europiane të Kombëtares “Shpresa” në futbollin shqiptar në vitet 1978, 1981, 1983

Msc.Kristaq Miço³⁴

Historian dhe specialist i sportit të futbollit

Prof.As.Dr Shyqyri Reli³⁵

Trainer Kombëtar,

Msc.Ramazan Ragami³⁶

Trainer Kombëtar

Abstrakt

Studimi me temë : “Sukseset Ballkanike dhe Europiane të Kombëtares Shpresa në futbollin shqiptar gjatë viteve 1978, 1981, 1983” trajton në mënyrë përshkruese arritje të futbollit shqiptar të cilat kanë qënë baza e një evolucioni në sportin e futbollit. Përveç të tjerash, në qendër të studimit qëndrojnë suksese të futbollit shqiptar, të kombëtares Shpresa në vitet 1978, 1981 si dhe pjesëmarrja në kampionatin European të futbollit në vitin 1983, duke zënë vendin e parë në grup dhe duke lënë prapa Gjermaninë, nënkampionen e Europës, por dhe Turqinë e Austrinë. Shqipëria për herë të parë kualifikohet në 8-shen e Europës, ndërsa në Dhjetor 1984 në një sondazh të revistës “World Soccer” të Anglisë Shpresën e Shqipërisë e rendit të 8-tën në 10 skuadrat më të mira të botës. Autorët, me anë të analizës SWOT të këtyre arritjeve nxorën në dukje treguesit përkatës. Të tillë rezultuan sukseset e ekipeve shpresa lidheshin ngushtë me masat që morën federatat sportive si dhe shteti shqiptar për përmirësimin dhe ngritjen e një sistemi organizativ për zhvillimin e cilësisë së lartë sportive, ngritja e klasave sportive në shkollat 9- vjeçare dhe më vonë edhe në shkollat e mesme, sistemi i përgatitjes së sportistëve duke u shoqëruar edhe me ngritjen e ekipeve zinxhir në klubet sportive. Në mënyrë të ndjeshme masat e mëdha organizative u shoqëruan edhe me ngritjen e një baze materiale të fuqishme e cila konsistonte në ngritjen e mjediseve sportive si dhe bazës didaktike materiale për zhvillimin me nivel të lartë të sportit. Një tjetër gjë pozitive rezultoi në studim kualifikimi i kuadrit mësues dhe trainer për përvetësimin e njohurive dhe të rejave të shkencës sportive si dhe pjesëmarrjen e Shqipërisë në të gjitha veprimtaritë ndërkombëtare Ballkanike, Europiane dhe Botërore për të gjitha sportet. Studimi merr një rëndësi të veçantë pasi tregon qartë që për të siguruar një sukses është e rëndësishme një planifikim mbi baza të shëndosha organizative, të bazuar në objektiva afatshkurtra dhe afatgjata . Kjo gjë siguron jo vetëm rezultat sportiv, por gjithashtu një kontribut në drejtim të forcimit të miqësisë dhe marrëdhënieve reciproke në rajon.

Fjalë kyçe: Ekipe Shpresa, futboll, Analiza SWOT, strategji, rezultate.

³⁴ kmico@hotmail.com

³⁵ shreli@yahoo.com

³⁶ rragami@yahoo.com

1925. Rrethi çiklistik, shqiptar i pari për amatorë

Prof.Dr.Lluka Heqimi³⁷

Pedagog i shkencave të edukimit UMB

Msc.Ilirjan Çule³⁸

Ekspert i sportit të çiklizmit

Msc.Dëfrim Methasani³⁹

Gazetar sportiv. RTVSH

Msc.Genc Angjeli⁴⁰

Ekspert i sportit të çiklizmit

Abstrakt

Ky studim sjell në fokus faktin që rrethi i parë për çiklistët amatorë në vendin tonë është veprimtaria e parë në këtë disiplinë sportive. Ishin hulumtimet e njërit nga gazetarët më të njohur sportiv Besnik Dizdari që solli këtë zbulim në historinë e çiklizmit shqiptar. Autorët kanë zbuluar fakte e të dhëna të mbështetura në dokumenta arkivore si dhe botime jo vetëm brenda vendit, siç është revista “Le monde de cyklist” në maj të vitit 1992. Interesante është gjetja e fakteve që dëshmojnë superioritetin gati të pabesueshëm me fqinjët, një diferencë 12 vjeçare. Ish-Jugosllavia dhe Rumania e kishin zhvilluar organizimin e garave çiklistike në vitin 1937 dhe Bullgaria 1 vit më vonë, ndërsa Turqia dhe Greqia vetëm mbas luftës. Materiale filmike si dhe dëshmi të personave të afërt të figurave të shquara si Cuk Skjapi apo Ndreka Milla janë përdorur dhe vijojnë të përdoren nga organizatorë të sporteve në qytet duke duke vijuar këtë traditë tashmë të merituar për tu quajtur “Qyteti i biçikletave”

Në këtë shkrim sillen fakte të tjera për pjesëmarrësit, shkrime në gazeta dhe opinione të ndryshme. Ky kërkim shkencor u krye me synimin jo vetëm në promovimin e vlerave sportive të popullsisë së Shkodrës, por mbi të gjitha për të ndikuar në një qasje gjithnjë e më shumë në drejtim të këtij sporti sa të dashur po aq praktik dhe me një ndikim të drejtpërdrejtë në pëmirësimin e cilësisë së jetës dhe krijimin e urave lidhëse në nivel ballkanik e europian me anë të veprimtarive sportive në këtë lloj sporti.

Fjalë kyçe: Rreth çiklistik, amatorizëm, traditë, rezultat, stil jetese.

Minella Kapo, themeluesi i qendrës shkencore të sportit dhe i mjekësisë sportive

³⁷ lluka.heqimi@gmail.com

³⁸ ilircule@yahoo.com

³⁹ dmethasani@yahoo.com

⁴⁰ genciangjeli@gmail.com

Abstrakt

Punimi shkencor trajton personalitetin e Prof.Minella Kapo, i cili ka themeluar mjekësinë sportive, sektorin kërkimor shkencor të sportit dhe drejtuar FSHA dhe SKSHS në vitet 1968-1987. Qëllimi i këtij studimi është; të analizojë veprimtarinë metodologjike dhe kërkimore shkencore të Prof.M.Kapos në dy periudha të veprimtarisë së tij sidomos drejtuese dhe eksperimentuese.

Metodologjia e përdorur për këtë punim është shtrirë në dy etapa dhe kap një periudhë kohorë prej 20 vjetësh. Etapa e parë e analizës ka të bëjë me vitet 1968-1978, ndërsa etapa e dytë kap vitet 1979-1987. Autori ka marrë në konsideratë vendimet që ka marrë ky personalitet i sportit për periudhën 1982-1987, si dhe janë bërë lidhje dhe analiza dhe midis kërkimit shkencor të bërë nga M.Kapo dhe kërkimit shkencor të periudhës së sotme.

Analiza nis me vitet 1968-1972, të cilat kanë lidhje me nismën në përgatitjen për arritje cilësore në sportin e atletikës. Në këtë periudhë risi ka qenë stërvitja sportive me moshat e reja 11-13 vjeç. Kjo risi u konkretizua kur ky personalitet drejtonte FSHA. Nisma e dytë ka lidhje me krijimin e mjekësisë sportive dhe sektorit kërkimor-shkencor të sportit. Nëse do të bazohemi në bindjet e asaj periudhe duhet theksuar se sporti konsiderohej si veprimtari vetëm praktike, ndërsa Prof. M.Kapo ndërmori nismën e vështirë të krijimit të shkencës sportive. Nisma e tretë ka lidhje me kërkimin shkencor, e cila kulmon me studimin gjigant “studimi i treguesve fizik të moshave 6-60 vjeç në Shqipëri”. Ky studim është bërë në treguesit antropometrik dhe fizik të popullatës nga Tropoja deri në Sarandë.

Fjalë kyçe: Themelues i mjekësisë sportive, kërkim, periudha studimi, analiza, reflektive

⁴¹ akarriqi@ust.edu.al

Barleti Volej, zhvillimi dhe perspektiva e një ekipi të ri.
(*Barleti Volej për të katërtin vit radhazi Kampion Shqipërie*)

Msc. Enkeleda Braho⁴²

Pedagoge e shkencave sportive UMB

Prof.Dr.Vejsel Rizvanolli⁴³

Pedagog i shkencave sportive

Msc.Eldo Xhija⁴⁴

Drejtor Marketing: GIG,Sukth, Durrës

Msc.Hasan Gurabardhi⁴⁵

Trajner i Ekipit “Barleti” Volej

Abstrakt

Autorët paraqesin në këtë artikull proceset dhe punën e vijueshme, si dhe rezultatet shumë pozitive të arritura të “Barleti Volej” që nga krijimi i këtij ekipi deri më sot, sukses që ka një impakt shumë pozitiv në mjediset sportive të volejbollit shqiptar, si dhe në masën e gjërë të rinisë shkollore.

Është marrë në analizë pjesëmarrja dhe karakteristikat e vajzave për formimin e ekipit, i cili cdo vit ka pësuar ndryshime cilësore dhe sasiore, duke rritur një nga parametrat më kryesorë të lojës së volejbollit, shtatlartësinë, si dhe moshën e re dhe mesatare të vajzave të afzuara në skuadër. Janë bërë analiza dhe ballafaqime me skuadra të tjera të vendit, por dhe duke i krahasuar me skuadra të Ballkanit.

Të gjitha të dhënat e mbledhura, të dokumentuara me grupe pune, janë analizuar, përpunuar, duke nxjerrë mangësitë, anët pozitive të skuadrës, si dhe cilësitë e lojtarëve në veçanti. Për këtë janë bërë planifikime afatshkurtra dhe afatgjata. Rëndësi të madhe i kemi kushtuar analizës së rritjes së kërcyeshmërisë si dhe futjes së elementeve modern të lojës si: shërbime me kërcim, realizim i bllokut tresh, dublazhet etj.

Përveç rezultateve të arritura gjatë këtyre viteve të fundit përmendet që ekipi me strategjinë dhe planifikimin e tij rezulton se është në rrugë të drejt dhe një shembull për t’u ndjekur nga të tjerët.

Fjalë kyçe: Barleti Volej, rezultate, planifikim, arritje, motivim, shembull.

⁴² enkibraho@gmail.com

⁴³ vrizvanolli@yahoo.com

⁴⁴ eldo.xhija@gmail.com.com

⁴⁵ hasangurabardhi@yahoo.com

Arritje të shahut në konkurimet ndërkombëtare

Msc. Aldo Zadrira⁴⁶

Jurist, Mjeshtër Sporti

Prof. Dr. Floran Vila⁴⁷

Pedagog FSHN, UT

Msc. Semi Numani⁴⁸

Historian i sportit të shahut

Abstrakt

Shahu shqiptar ka njohur sukseset e veta në konkurimet ndërkombëtare. Faktorët që ndikojnë në një pjesëmarrje të qëndrueshme dhe konkurruese në shah janë komplekse dhe të një spektri të gjerë që lidhen me trashëgiminë, me edukimin, me gjininë, por dhe me interesin që shfaqet për mbështetjen e strukturave në shërbim të sportit të shahut. Objekt i artikullit “Arritje të shahut në konkurimet ndërkombëtare” është analiza dhe rezultatet e tre sportistëve shahistë në ndeshje në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Synimi i këtij prezantimi është pasqyrimi i këtyre arritjeve dhe krahasimi i rezultateve të tilla me arritjet në 10- vjeçarin e fundit. Trajtimi i të dhënave në mënyrë përshkruese dhe analizimi i tyre me anë të metodës krahasuese dëshmon se, gjatë lojës së shahut, dy elemente janë të domosdoshme të tillë si: progresiviteti në pjesëmarrje dhe cilësia e lojës. Në dekadën e fundit të dhënat të shqyrtuara për shahun tregojnë një marrëdhënie të njëjtë të këtyre dy variablave, që do të thotë rritje e numrit të pjesëmarrjes apo të të ushtruarit të këtij sporti veçanërisht në moshën e fëmijëve, gjë e cila po shikohet dhe me futjen e tij në sistemin arsimor parauniversitar në Shqipëri. Vendosja e sistemit të licensimit si dhe pjesëmarrjes në të me femra e meshkuj në konkurimet e shahut, po ndërgjegjësojnë për cilësi loje. Punimi është me interes sepse ndodhemi në një situatë mobilizimi për të mirëpritur kampionatin botëror të shahut për shkollat e arsimit parauniversitar, por dhe shumë projekte ambicioze në të ardhmen.

Fjalë kyçe: Shah, edukim, progresivitet, pjesëmarrje, të ushtruarit.

⁴⁶ aldozadrim@yahoo.com

⁴⁷ florianvila@yahoo.com

⁴⁸ seminumani2001@yahoo.com

Normalja e Elbasanit dhe kontributi i Dr. Besim Ismail Qorrit në fushën e Edukimit fizik dhe të sportit.

Prof. As.Dr Ardian Shingjergji⁴⁹

Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan

Abstrakt

Qyteti i Elbasanit, nga gjiri i tij, ka nxjerrë mjaft figura të shquara që kanë lënë gjurmë pothuajse në të gjitha fushat e jetës si: në atë të shkencës, gjuhësisë, historisë, biologjisë, mësuesisë e pedagogjisë, edukimit fizik e sportit.

Në këtë kuadër, synimi i këtij punimi është të sjellë në vëmendje e të rivlerësojë rolin dhe kontributin e “Normales” së Elbasanit, të nxënësve dhe mësuesve të saj, në përhapjen dhe zhvillimin e Kulturës Fizike e Sportit, jo vetëm në qytetin e Elbasanit, por në mbarë Shqipërinë dhe trevat shqipfolëse jashtë saj. Një nga nxënësit e kësaj shkolle është edhe Dr. Besim Qorri, i cili u shqua për ndihmesën e tij të vyer, jo vetëm si mësues, por edhe si përkthyes, studiues, hulumtues e analist i spikatur në fushën e Edukimit Fizik e Sportit (veçanërisht të futbollit). Më tej, në punim, sillen në vëmendje edhe roli e kontributi i mjaft figurave futbollistike të qytetit të Elbasanit, të cilët përfaqësuan me dinjitet skuadrën e qytetit të tyre ndër vite, jo vetëm në aktivitetet kombëtare, por edhe në aktivitetet ndërkombëtare ballkanike apo europiane.

Fjalë kyçe: Edukim Fizik, Sport, futboll, vlerësim, “Normalja”, Dr. Besim Qorri.

⁴⁹ ardianshingjergji@gmail.com

Ekipe të suksesshme dhe personalitete të basketbollit shqiptar.

Prof. As. Dr. Gavrosh Kavaja⁵⁰

Pedagog i shkencave sportive UMB

Msc.Eduart Çarçani⁵¹

Pedagog i shkencave sportive UMB

Prof.As.Dr. Spiro Kuvarati⁵²

Pedagog i shkencave të edukimit UST

Abstrakt

Autorët e këtij prezantimi trajtojnë rezultatet pozitive të ekipeve shqiptare, më në zë, të basketbollit gjatë viteve 1945-1992, por dhe personalitetet më të spikatura të këtij sporti. Janë analizuar tri periudha historike të zhvillimit dhe arritjeve të basketbollit përkatësisht vitet 1946-1958 ku u hodhën themelet e basketbollit, vitet 1958-1969 ku po përmirësohej cilësia e basketbollit, si dhe vitet 1968-1991 ku u njohën suksese brenda dhe jashtë vendit. Secila periudhë evidenton emra të shquar të basketbollit si lojtarë dhe trajnerë shqiptarë dhe të huaj, të cilët kanë kontribute dhe vlera. Autorët nëpërmjet analizës së dokumentacioneve, shqyrtimit të mjaft materialeve të arkivave sportive, por dhe me anë të fakteve të mbledhura në tryeza pune, në biseda profesionale me sportistë që kanë jetuar në këto kohëra, kanë arritur të paraqesin arritjet e basketbollit, duke i krahasuar dhe me basketbollin evropian. Janë identifikuar pikat të forta dhe të dobëta, si dhe nevojat për përmirësim të cilësisë së basketbollit, por dhe jepen rekomandime që lidhen me mbështetjen më të madhe financiare dhe profesionale nga institucionet shtetërore dhe private me anë të strategjive të mirëfillta zhvillimore, por dhe ne veçanti për proceset e identifikimit, trajnimit dhe cilësisë sportive që duhet të performojnë burimet njerëzore që merren me sportin e basketbollit.

Fjalë kyçe: Basketboll, periudha zhvillimi, përmirësim, cilësi, mbështetje

⁵⁰ gkavaja@hotmail.com

⁵¹ ecarcani@yahoo.com

⁵² skuvarati@ust.edu.al

Faktorët përcaktues në rezultatet në rritje në sportin e mundjes

Msc.Viron Bezhani⁵³

President i Komitetit Olimpik Kombëtar shqiptar

Msc.Ylli Agolli⁵⁴

Trainer Kombëtar

Msc.Elis Guri⁵⁵

Kampion Botëror

Abstrakt

Duke u nisur nga fakti që mundja në vendin tonë është ndër sportet më të lashtë, autorët ndërmorën një studim me temë: “ Faktorët përcaktues në rezultatet në rritje në sportin e mundjes”. Synimi i këtij studimi ishte evidentimi i ecurisë së këtij lloji sporti ndër vite në drejtim të rezultateve të arritura si dhe gjetja e faktorëve dominues që sigurojnë një vazhdimësi pjesëmarrjeje dhe cilësi sportive në të njëjtën kohë. Metodologjia e këtij studimi u bazua mbi evidentimin dhe analizimin e të dhënave të grumbulluara mbi numrin e pjesëmarrësve në këtë sport që nga kampionati i parë ndërkombëtar në vitin 1948 . Një analizë përshkuese mbi arsyet që kanë sjellë rezultate në rritje u krye me anë të pyetësorëve dhe intervistave të marra nga ish trajnerë, trenerë aktual, drejtues federate, specialist sportesh si dhe vetë sportistë të cilësisë sportive. Nga përpunimi i të dhënave rezultoi se mundja arriti të zhvillohej e të kishte sukses pasi krahas përgatitjes së sportistëve, ajo i vuri një rëndësi të madhe edhe punës së trajnerëve dhe konkretisht kualifikimit të tyre jashtë vendit, angazhimit të gjyqtarëve në gjykime të eventeve ndërkombëtare (mbi 20 gjyqtarë). Një tjetër faktor i rëndësishëm rezultoi qasja e sponsorëve të ndryshëm që i kanë dhënë mbështetje këtij sporti duke bërë të mundur një traditë shumë të mirë në organizimin e aktiviteteve ndërkombëtare në vendin tonë. Ky studim do t'i shërbejë specialistëve të sportit të mundjes të mbështeten mirë në faktorët që kanë siguruar këtë ecuri si dhe të gjejnë rrugë e mjete të reja për ta ruajtur e ta forcuar këtë traditë të popullit tonë në sportin e mundjes.

Fjalë kyçe: Mundje, traditë, rezultate, specialist sporti, sponsor.

⁵³ vbezhani@yahoo.com

⁵⁴ yliagolli@yahoo.com

⁵⁵ elisguri@yahoo.com

Jo vetëm krenari por edhe vlerë kombëtare

Msc. Silvana Delia⁵⁶

Pedagoge e shkencave sportive UMB

Msc. Ilia Kuro⁵⁷

Pedagog i shkencave sportive UMB

Prof.Dr. Lumturi Markolaj⁵⁸

Pedagoge e shkencave sportive UST

Abstrakt

Atletika, “Mbretëresha e Sporteve” trajtohet në prezantimin “Jo vetëm krenari por edhe vlera kombëtare” si një veprimtari e cila identifikon dhe prezanton rolin e tempit të zhvillimit jo vetem të rezultateve sportive, por edhe vlerave profesionale përtej aktivitetit sportiv. Objektiv i kryesor i këtij studimi ishte evidentimi i tempit të zhvillimit të ish rekordmenes së garës së kërcimit së larti të Znj.Marjeta Zaçe dhe krahasimi i të njëjtit tregues me atlete të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar. Kërkimi është bërë kryesisht duke u fokusuar në vëzhgimin e faktorëve që ndikojnë në tempin e zhvillimit duke analizuar shumë fakte, përvoja të dokumentuara në botime dhe revista si dhe kontakti i drejtpërdrejtë, rezultatet e të cilave u analizuan. Prezantimi evidenton arritjet kryesore të kësaj figure të shquar si profesioniste e fushës së sportit por edhe në drejtime të tjera të rëndësishme ku midis të tjerash spikat kontributi në kërkimin shkencor, duke i dhënë kështu vlera të konsiderueshme shoqërisë shqiptare në fushën e edukimit dhe zhvillimit social - kulturor. Nga studimi i rezultateve të kësaj figure duket qartë përmbushja e synimit të këtij studimi i cili thekson dhe sugjeron domosdoshmërinë e respektimit të kriterëve të tempit të zhvillimit dhe vlerësimi i arritjeve përtej kontureve të ativitetit sportiv si një vlerë e që duhet promovuar për të patur sa më shumë sukses në përpjekjet e përbashkëta për integrimin në Bashkimin European me anë të sportit.

Fjalë kyçe: Rekord, ballkaniada, temp zhvillimi, kërkim shkencor, promovim

⁵⁶ silvalinda65@hotmail.it

⁵⁷ kilia@yahoo.com

⁵⁸ lmarkolaj@ust.edu.al

Rekordi Kombëtar prej 31 vitesh i mbajtur nga rekordmeni Ajet Toska, një dëshmi e përpjekjeve të sportit cilësor

Msc. Ilia Kuro⁵⁹

Pedagog i shkencave sportive UMB

Msc. Silvana Delia⁶⁰

Pedagoge e shkencave sportive UMB

Prof. As.Dr. Fatbardha Kovaçi⁶¹

Pedagoge e shkencave sportive UST

Abstrakt

Një nga garat më të bukura në sportin e Atletikës, “ Flakja e Çekiçit” është objekt i këtij studimi. Në këtë garë rekordi kombëtar është vendosur nga rekordmeni Ajet Toska që prej 31 vitesh e deri më sot. Fakti që ky rekord prej kaq vitesh është ende i pathyer, ka nxitur autorët të studiojnë progresivitetin e këtij sporti dhe sportisti në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë studim autorët synojnë të paraqesin gjetjet e tyre kërkimore në të analizuarit e suksesit të këtij atleti me një historik medaljesh, si: 1 medalje ari, 10 medalje bronxi, 3 medalje argjendi në ballkaniada e takime të ndryshme ndërkombëtare. Janë analizuar konkretisht faktorët fizikë, teknikë dhe taktikë të arritjes së performancës së lartë të këtij sportisti. Metodologjia kërkimore e përdorur në këtë analizë përfshin metodën e hulumtimit të protokolleve të garave, hulumtimin historik të rezultateve kombëtare dhe ndërkombëtare në federatën e atletikës si dhe intervista/pyetësi, e marrë në mënyrë të drejtpërdrejtë me rekordmenin. Nga analiza e bërë mbi rezultatet e marra nga përpunimi i të dhënave dalin në dritë faktorët dominues në sigurimin e një rezultati të dëshiruar apo elementet përcaktues të arritjeve dhe rezultateve rekord. Nga më të spikaturit ishin faktorët motivues jo vetëm të vetë atletit por edhe të mjedisit social, përgatitje sportive e nivelit të lartë dhe sistematike, si dhe një përgatitje e lartë psikologjike. Gjetjet e këtij studimi përbëjnë një bazë të shëndetshme mbi të cilat duhet të fokusohemi për të siguruar cilësi sportive dhe me anë të kësaj një edukim sportiv në një bazë më të gjerë me anë të shembullit më të mirë.

Fjalë kyçe: Rekord, përgatitje fizike, edukim, intervistë, feedback.

⁵⁹ kilia@yahoo.com

⁶⁰ silvalinda65@hotmail.it

⁶¹ bkovaci@ust.edu.al

Përprojekjet e basketbollit shqiptar në vitet e fundit për t'u integruar në basketbollin ballkanik e më gjerë.

Msc. Ervin Koci⁶²

Pedagog i shkencave sportive UMB

Msc. Ledina Koci⁶³

Pedagoge e shkencave sportive UST

Abstrakt

Në vitet e fundit është shtuar gjithnjë e më vrullshëm dëshira e komunitetit të basketbollit për t'u përballur në arenën ndërkombëtare, duke filluar nga ajo ballkanike dhe më tej atë europiane. Qëllimi i këtij studimi nuk është thjesht evidentimi i numrit të ndeshjeve të skuadrave tona në arenën ndërkombëtare, por një vështrim konkret mbi përprojekjet e basketbollit shqiptar për t'u integruar në arenën ballkanike dhe atë europiane, duke e krahasuar atë me vendet e rajonit. Për të vlerësuar këto përprojekje janë analizuar numri i aktiviteteve dhe ndeshjeve ndërkombëtare, si për skuadrat përfaqësuese ashtu edhe për klubet dhe shoqatat.

Për këtë qëllim u morrën në shqyrtim numri i ndeshjeve ndërkombëtare, por jo vetëm. U analizua edhe numri i ndeshjeve në total gjatë një sezoni që zhvillojnë skuadrat tona, duke e krahasuar në këtë mënyrë me ato të rajonit. Në përshtatje të objektivit studimor autorët morën në analizë skuadrat kampione të dhjetë viteve të fundit në basketboll për meshkuj si edhe të skuadrës përfaqësuese meshkuj në 10 vitet e fundit. Hipotezat e tyre në këtë studim ishte: A është i mjaftueshëm numri i ndeshjeve, duke përfshirë natyrisht edhe ato ndërkombëtare krahasuar me skuadrat e rajonit? Cili është ndryshimi midis tyre? Me këtë studim autorët, mendojnë se do t'i shërbejnë sado pak përmirësimit të punës së komunitetit të basketbollit, në veçanti klubeve dhe shoqateve, duke e konsideruar pjesëmarrjen në aktivitete ndërkombëtare si element themelor të zhvillimit të sportit (basketbollit meshkuj në rastin tonë).

Fjalë kyçe: Basketboll, numër ndeshje, analizë, cilësi, arenë ndërkombëtare.

⁶² ervinkoci@yahoo.com

⁶³ ledinakoci@ust.edu.al